



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

Nr. 162/3 Prot

Tiranë, më 12.02. 2020

VENDIM

Nr. 4, datë 12.02.2020

“PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NË UPT,
PËR VITIN AKADEMIK 2021 – 2022”**

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, gërma a, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 9, pika 3, gërma a, Senati në mbledhjen e datës 12.02.2020,

VENDOSI:

Miratimin e kriterëve të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në UPT, për vitin akademik 2021 – 2022.

Kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë, të ofruara nga Fakultetet e UPT janë si më poshtë:

A. 1. Fakulteti I Inxhinierisë Mekanike me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Mekanike
- Bachelor në Inxhinieri Materiale
- Bachelor në Inxhinieri Tekstili dhe Modë
- Bachelor në Inxhinieri Ekonomike

2. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike me programet e studimit:

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

- Bachelor në Inxhinieri Elektrike-Profilu Automatizim i Industrisë
- Bachelor në Inxhinieri Elektrike-Profilu Energjitikë
- Bachelor në Inxhinieri Mekatronike

3. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minerave me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatikë
- Bachelor në Inxhinieri e Burimeve minerare
- Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit
- Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi
- Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike

4. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi
- Bachelor në Inxhinieri Hidroteknikë
- Bachelor në Inxhinieri Mjedisi
- Bachelor në Inxhinieri Gjeodet

5. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Matematike
- Bachelor në Inxhinieri Fizike

janë si më poshtë vijon:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2021-2022.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * Mes_{(VKM)} + 0.3(0.5 * Mes_{(Matematike)} + 0.4 * Mes_{(Fizike)} + 0.1 * Mes_{(Kimi)})] * K_{koef.} \\ \text{Shkollës} * 1000$$

Ku:

- $Mes_{(VKM)}$, nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2021 – 2022, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e Lartë dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;

- **Mes_(Matematike)**, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;
- **Mes_(Fizike)**, nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;
- **Mes_(Kimi)**, nota mesatare e thjeshtë e kimisë në të gjitha vitet e shkollës së mesme përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;
- **K_{koef. Shkollës}**, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2021 – 2022, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2021 – 2022.

B. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Elektronike
- Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni
- Bachelor në Inxhinieri Informatike

ka vendosur këto kritere:

- Kandidatët duhet të plotësojë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2021-2022.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * Mes_{VKM} + 0.3(0.6 * Mes_{Matematike} + 0.4 * Mes_{Fizike})] * K_{koef. Shkollës} * 1000$$

Ku:

Mes_{VKM}, nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2021-2022, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;

Mes_{Matematike}, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore në provimet e detyruara dhe në provimet me zgjedhje;

Mes_{Fizike}, nota mesatare e thjeshtë e fizikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme përfshirë rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2021 – 2022, sipas tabelës së koeficienteve për vitin akademik 2021 – 2022

C. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, për programet e integruara të studimit:

- Master i Shkencave në Arkitekturë-Profilu Arkitekt
- Master i Shkencave në Arkitekturë-Profilu Urbanist

Dhe për programin e studimit:

- Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn

ka vendosur këto kritere:

- Kandidatët duhet të plotësojë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik përkatës.
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$0.6 * Mes_{(VKM)} * K_{koef. Shkollës} * 1000 + 0.4 * T_{(Testi)} * 100$$

Mes_(VKM), nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2021 – 2022, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;

K_{koef. Shkollës}, koeficienti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2021-2022.

T_(Testi), rezultati i testimit, i organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, i cili përbëhet nga katër (4) komponentë:

- Test i arsyetimit logjik 25% e T_(Testi), (25 pikë)
- Test i kulturës së përgjithshme 25% e T_(Testi), (25 pikë)
- Test i historisë dhe historisë së arkitekturës 25% e T_(Testi), (25 pikë)
- Test i vizatimit dhe prezantimit 25% e T_(Testi), (25 pikë)



KRYETARI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al